

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. D-01 D-02 D-03 D-04 D-05 D-06 D-07 D-08 D-09 D-10 D-11 D-12 D-13 D-14 D-15 D-16 D-17 D-18 D-19 D-20 D-21 D-22 D-23 D-24 D-25 D-26 D-27 D-28 D-29 D-30 D-31 D-32 D-33 D-34 D-35 D-36 D-37 D-38 D-39 D-40 D-41 D-42 D-43 D-44 D-45 D-46 D-47 D-48 D-49 D-50 D-51 D-52 D-53 D-54 D-55 D-56 D-57 D-58 D-59 D-60 D-61 D-62 D-63 D-64 D-65 D-66 D-67 D-68 D-69 D-70 D-71 D-72 D-73 D-74 D-75 D-76 D-77 D-78 D-79 D-80 D-81 D-82 D-83 D-84 D-85 D-86 D-87 D-88 D-89 D-90 D-91 D-92 D-93 D-94 D-95 D-96 D-97 D-98 D-99 D-100	Nr. Prot. B-Prot Prot. No. 03-2953/12
Nr. i rastit 02	Date Datum 22.08.2012
Re.I.nr.641/2012	

**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË DRAGASH,** gjyqtari Bekri Vehapi në procedurën kundërvajtse kundër të pandehures Zinaida Elmazi nga fshati Mlikë komuna e Dragashit, për kundërvajtje sipas nenit 17 pika 1 dhe 3 të Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollimin e pasurisë të zyrtarve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollimin e dhuratave për gjithë prsonat zyrtar, Ligji nr.04/L-050, e në bazë të nenit 73, 74 dhe neni 195 par. 1 të Ligjit mbi kundërvajtjet, me datën 14.08.2012, merrë këtë

## A K T V E N D I M

E PANDEHURA Zinaida Elmazi nga fshati Mlikë komuna e Dragashit, Muslimane, Shtetasë i Republikës së Kosovës, punëtor, me banim të përherëshëm në vendlindje.

## ËSHTË PËRGJEGJËS

Për arsye se si zyrtar i lartë publik, në afatin e përcaktuar ligjor, gjegjësisht deri me 31.mars të vitit 2012, nuk e ka përmbushur obligimin ligjor, nuk e ka plotësuar dhe dorzuar formullarin për deklarimin e pasurisë Agjencionit kundër korrupsionit.

Me që rast i pandehuri ka kryer kundërvajtje të sanksionuar sipas nenit 17 pika 1/3 të Ligjit nr.04/L-050, e në bazë të kësaj dispozite e konform nenit 10 të LMK-së, bëhet zbutja e denimit dhe i pandehuri,

## DENOHET

### ME QORTIM.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 5 Euro, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotëfuqishmerisë së këtij aktvendimi, në llogarin bankare përmesë kësaj Gjykate.

## A r s y e t i m

Me kërkesën e Agjencionit kundër korrupsionit të Kosovës në Prishtinë, 01-2152/2012, të dt. 04.06.2012, Gjykata për kundërvajtje me konkluzion e ka filluar procedurën kundërvajtëse kundër të pandehures Zinaida Elmazi me të dhënat si në dispozitiv të aktvendimit.

E pandehura Zinaida Elmazi në seancën e shqyrtimit verbal sipas proqesverbalit, gjegjësiaht për mes deklarimit me shkrim ka deklaruar se nuk ka qenë i njoftuar me dispozitën ligjore dhe se nuk ka patur në dispozicion formullarin për deklarimin e pasurisë, se për këtë qështje për herë të parë është njoftuar nga gjykata për kundërvajtje. Ka deklaruar se me të u njoftuar me obligimin ligjor, menjëher me dt. 02.08.2012 e ka paraqit formullarin dhe njëherit e ka bërë deklarimin e pasurisë. Ka kërkuar nga gjykata që gjatë vendosjes dhe marrëjes së aktvendimit të ketë parasysh faktet e prezentuara të cilat fakte do të shërbejnë si rrethana letësuese.

03-293-5/12/02  
Sluz

Gjykata ka lexuar shkresat se lendes te Agjencionit kunder korruptcionit, deklaraten e te pandehures, deshmit e prezentuara dhe pa dyshim eshte konstatuar dhe vertetur se i pandehuri Zinaida Elmazi si zyrtar publik i obliguar per ta deklaruar pasurin, ne afatin e percaktuar ligjor si ne dispozitiv nuk e ka plotesuar dhe nuk i ka derguar formularin Agjencionit me se voni deri me dt.31.03.2012.

Me keto veprime ka kryer kundervajtje te sanksionuar me nenin 17 pika 1 dhe 3 te Ligjit nr/04/L-050

Gjykata ndaj te pandehurit konform nenit 10 te LMK-se e ka ber zbutjen e denimit nga rrethanat, se i pandehuri per here te pare ka kryerer kundervajtje te kesaj natyre, se nuk ka qene i informuar mire me Ligjin nr. 04/L-050 dhe obligimet sipas ketij Ligji, se me te njoftuar me obligimin Ligjor me dt.15.06.2012 permes formularit e ka ber deklarimin e pasuris.

Me sa u tha me larte eshte vendosur si ne dispozitiv te keti aktvendimi.

U VENDOS NE GJYKATEN KOMUNALE PER KUNDERVAJTJE NE  
DRAGASH, Me daten 14.08.2012, Re.I.nr.641/2012.



**KËSHILLA JURIDIKE;** kundër ketij aktvendimi parashtruesi i kerkeses dhe i pandehuri kanë te drejten e ankimit ne Gjykatën e larte per kundervajtje ne Prishtine ne afat prej 8 ditesh, nga dita e pranimit te keti aktvendimi. Ankesa dergohet me shkrim me 2.egzenplar pa taksa permesë Gjykates komunale per kundervajtje ne Dragash.